



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0027424-1/24 dt. 29.04.2024

Mitrovicë

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 28

Koha: 29.04.2024 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shoshollı Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamed Hoti dhe Xhylljeta Imeri

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Drejtoret e Drejtive

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoit Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteteve të përhershme dhe komiteteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e njëzetetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Kërkesë për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale
3. Raport finansiar për periudhën janar-mars 2024

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Kërkesën për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të pikës nga Drejtoresha e DBF-së znj. Igballe Islami, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Kryetari Bedri Hamza: Ndryshimet (eksperimentale) në Ligjin e buxhetit po na krijojnë vështirësi në realizim të projekteve, të hyrat vetanake janë në diskrecion të Komunës, andaj forma e transferit dhe rialokimit të mjeteve këtë vit uroj të mos përsëritet më. Ju lus ta përkrahni propozimin në mënyrë që ta shpenzojmë buxhetin në formën më të mirë.

Hysen Muzliukaj: KPF prej që ekziston, po ashtu edhe Kuvendi kurrë më korrekt nuk kanë qenë me votim kur ka pasur projekte në të mirë të qytetarëve. Sa i përket ndryshimeve në ligj që i përmende Kryetar, ideja e ligjit është te projektimi, ne e kemi edhe KAB-in ku i fusim projektet, këtu lidhet pikërisht me projektimin, me planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm, i sheh projektet e planifikuara në vitin 2022 ndërsa në vitin 2023 e sheh që asnjë hap nuk është ndërmarrë në këtë projekt dhe kjo i bie keqplanifikim, e kjo na len pasoja edhe për vitin e ardhshëm. Ideja është me planifikuar mirë e me shpenzuar shumë më mirë. Unë kërkoj që pagesa të mos bëhet pa pranim teknik, sepse po kryhet një pjesë e punës, po bëhet pagesa për atë punë të kryer, ndërsa pjesën tjetër po e lënë të pakryer. Do të ishte mirë ta bëjmë listën e zezë të operatorëve që nuk i kryejnë punët, atë listë ta publikojmë në ueb faqen e Komunës, ta dinë qytetarët se cilët janë këta operatorë që nuk i kryejnë punët. Prandaj komisionet për pranim teknik të punëve mos ta pranojnë asnjë punë që nuk është kryer mirë, dhe assesi të mos iu kryhet asnjë pagesë derisa të kryhen punët mirë. Përderisa nuk ka dënlime dhe penalizime prej komunës operatorët do të vazhdojnë t'i lënë punët e papërfunduara. Unë mendoj se ka punë për menaxhmentin në kuptimin e planifikimit, ka punë për komisionet e pranimit teknik të punëve apo menaxherët e kontratave, ka punë për planifikimin e shpenzimit, nëse përmirësohami në këto aspekte nuk do të ketë dështime.

Kryetari Bedri Hamza: Sa i përket planifikimit, ne KAB-in e bëjmë në bazë të një qarkoreje buxhetore që na vije nga niveli qendrorë, ndërsa kur po vije puna te buxheti po vjen një qarkore tjetër dhe po ta ndërron buxhetin paraprak. Buxheti prej ekzekutivit po planifikohet në muajin gusht, në fund të gushtit dorëzohet në asamble për miratim dhe qysh atëherë me ja qëlluar saktë sa do të jetë niveli i ekzekutimit të mjeteve deri më 31 dhjetor të vitit të ardhëm dhe a me bë projekt a jo, nuk është e lehtë, është goxha problematike. Fati i këtij ridestinimi dhe transferi është se të gjitha barten në projektet që kanë kontrata dhe nuk rrezikojmë që të njëjtat mjete edhe me i bartë edhe mos me i realizuar. Sa i përket transferit dhe rialokimit, jemi munduar që të barten sipas nevojave të Komunës, dhe munden me u shpenzuar kur të plotësohen kushtet.

Fadil Veseli: Përveç shqetësimeve me vend që i ceki Kryetari, këtu është fat i mirë që i kemi këto mjete dhe që do të barten në investime kapitale e që është në interes të qytetarëve. Në aspektin teorik disa punë po duken shumë të lehta, por kur po vije te zbatimi në praktikë po na sjellin goxha telashe e shumë herë edhe po na bllokojnë punë. Kontrata për ujëra të zeza po ngecë si në vitin e kaluar ashtu edhe këtë vit, ka kosto, por të gjendet një model e së paku të fillohet në disa zona më të ndjeshme.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesja vuri në votim Kërkesën për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale.

Kërkesa për transfer dhe rialokim të mjeteve në Investime Kapitale u miratua unanimisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe e njëjta i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Raportin finansiar për periudhën janar-mars 2024.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Raportin finansiar për periudhën janar-mars 2024.

Raporti finansiar për periudhën janar-mars 2024 u miratua unanimisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:45 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Merita PRETENI

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

